



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL

Nr. 10, datë 11.11.2025

I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Durrës që zhvillohet në sallën e Këshillit Bashkiak

Orari i fillimit të mbledhjes : 12:10

Data e mbajtjes së mbledhjes : 11.11.2025

Mbajtja e mbledhjes : Salla e Këshillit Bashkiak

Lloji i Mbledhjes: Mbledhje e Radhës

Përfaqësuesit e Bashkisë Durrës: Zëvendëskryetari i Bashkisë z.Elio Jani si dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen plenare.

Denisa Luarasi: Përshëndetje të nderuar këshilltarë !

I nderuar Zëvendëskryetar! Të nderuar të pranishëm dhe media.

Deklaroj të hapur këtë mbledhje të radhës Këshillit Bashkiak Durrës. Sot kemi për të shqyrtuar dhe miratuar 7 (shtatë) projektvendime të propozuara nga kryetarja e bashkisë. Materialet ju janë vënë në dispozicion nga Sekretaria e Këshillit.

Ftoj sekretaren e Këshillit të bëjë prezencën në sallë.

Dorina Milja: Përshëndetje ! Fillojmë...

Ardian Mukaderi tek.... Florian Tahiri...

36 këshilltarë. Është prezent edhe kandidati i ri për të marrë mandatin, Kastriot Xhongoli.

(V.O. Hyn me vonesë në sallë këshilltarët: Anila Kapidani, Bledar Prizreni dhe në fund ke diskutimet këshilltarja Edlira Shemsi).

Denisa Luarasi: : Faleminderit Dori.

Meqë kurumi është i pranishëm, vazhdojmë me mbledhjen. Po lexojmë pikat e rendit ditës..

Pika 1.	PËR MIRATIMIN E MANDATIT TË ANËTARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK Z. KASTRIOT FARIK XHONGOLI
Pika 2.	PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFITUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DERI 6% DHE FONDI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË DURRËS, PËR MUAJIN SHTATOR 2025
Pika 3.	PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFITUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DERI 6% DHE FONDI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË DURRËS, PËR MUAJIN TETOR 2025
Pika 4.	PËR KRIJIMIN E KËSHILLIT VENDOR TË SIGURISË PUBLIKE NË BASHKINË DURRËS DHE MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E TIJ
Pika 5.	PËR MIRATIMIN E UDHËZUESIT PËR MËNYRËN E APLIKIMIT “PËR IMPLEMENTIMIN E SKEMËS: GRANTE PËR TË RINJTË NË MBËSHTETJE TË ZHVILLIMIT TË INICIATIVAVE EKONOMIKE LOKALE”
Pika 6.	PËR MIRATIMIN E NDIHMËS FINANCIARE ME VLERË 3,061,841 LEKË, PËR FAMILJET QË KANË PËSUAR DËME SI PASOJË E RËNIES SË ZJARRIT NË BANESAT E TYRE
Pika 7 dhe e fundit	PËR MIRATIMIN E KALIMIT NË ADMINISTRIM TË VARREZAVE, TË NJËSIVE ADMINISTRATIVE RRASHBULL, SUKTH, KATUNDI I RI, MANËZ DHE ISHËM, TEK NDËRMARRJA E SHËRBIMEVE KOMUNALE DURRËS

Keni ndonjë koment?

Jeni dakort për rendin e ditës?

Kalojmë votim, kush është pro rendit të ditës?

Dorina Milja : Jo, ti Kastriot nuk voton tani tek rendi.

36 pro.

Denisa Luarasi: Atëherë me 36 vota pro miratohet pa ndryshime dhe rendi i ditës.

- I jepet fjala për projektvendimin **e pikës 1**, Komisionit të Mandateve me kryetare zonjën Ana Dharmo që të paraqesë raportin e verifikimit të mandatit.

Ana Dhamo: Përshëndetje!

Komisioni i Mandateve u mbledh dhe pasi shqyrtoj dokumentacionin e ardhur me anë të emailit, vendosi që ta kalojë për votim në mbledhjen sot të Këshillit Bashkiak.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Dhamo.

Ju ftoj që ta votojmë raportin e komisionit.

Kush është pro?

Dorina Milja : 37 pro, se ka ardh dhe Anila Kapedani.

Denisa Luarasi: Me 37 vota pro miratohet.

Zoti Kastriot Xhongoli, ju ftoj të ngriheni në këmbë. Do ju lexoj formulën e betimit dhe ju pas leximit do të thoni “betohem”.

“Betohem në nderin tim, se do të kryej me ndërgjegje detyrën e anëtarit të këshillit bashkiak dhe do t'i bindem kushtetutës dhe ligjeve. Betohem, se në të gjithë veprimtarinë time do të udhëhiqem nga interesat e shtetasve të bashkisë Durrës dhe do të punoj me ndershmëri e përkushtim për zhvillimin dhe rritjen e mirëqenies së tyre”.

Kastriot Xhongoli : Betohem.

Denisa Luarasi : Përpara keni formulën e betimit. Ju ftoj që ta firmosni.

Urime zoti Xhongoli, suksese dhe mirë se erdhët në këshillin tonë bashkiak.

Kastriot Xhongoli : Faleminderit.

Denisa Luarasi : Këshillit Bashkiak i plotësohet vakanca dhe ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

- I jepet fjala për projektvendimin **e pikës 2**, Komisionit të Barazisë Gjimore, Mirëqenies Sociale dhe Mosdiskriminimit, zonjës Xhiliola Doçi.

Xhiliola Doçi : Faleminderit.

Komisioni jonë u mbledh dhe miratoi me unanimitet votash pikat 2 dhe 3 t'i kalojë për miratim Këshillit Bashkiak.

Hekuran Markola : Pika 2.

Denisa Luarasi : Faleminderit zonja Doçi.

- I jepet fjala për projektvendimin e pikës 3, Komisionit të Barazisë Gjimore, Mirëqenies Sociale dhe Mosdiskriminimit, zonjës Xhiliola Doçi.

Dorina Milja : Kujdes. Kaloje në votim pikën 2.

Denisa Luarasi : O sorry.

Kalojmë në votim.

Kush është pro pikës 2?

Me 38 vota pro, miratohet pa ndryshime pika 2 e rendit të ditës.

- I jepet fjala për projektvendimin **e pikës 3**, Komisionit të Barazisë Gjinore, Mirëqenies Sociale dhe Mosdiskriminimit, zonjës Xhiliola Doçi.

Xhiliola Doçi : Edhe këtë pikë komisioni jonë e miratoi që të kalojë në Këshillin Bashkiak për miratim.

Denisa Luarasi : Faleminderit zonja Doçi.

Komente keni?

Kalojmë në votim.

Kush është pro?

Me 38 vota pro, miratohet pa ndryshime pika 3 e rendit të ditës.

- I jepet fjala për projektvendimin **e pikës 4** Komisionit Rregullores, Çështjeve Juridike zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj : Atëherë përshëndetje të gjithëve!

Komisioni ynë me shumicën e votave e miratoi pikën 4 dhe fton Këshillin sot që të japë votën pro. Faleminderit.

Denisa Luarasi : Faleminderit zonja Musaraj.

Komente, pyetje kemi për pikën 4.

Kalojmë votim.

Kush është pro për pikën 4 të rendit të ditës?

Me 38 vota pro miratohet pa ndryshime dhe pika 4 e rendit të ditës.

- I jepet fjala për projektvendimin **e pikës 5**, Komisionit Rregullores, Çështjeve Juridike zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë edhe për pikën 5, ne e votuam si komision dhe ftojmë Këshillin që të japë votën pro. Faleminderit.

Denisa Luarasi : Faleminderit zonja Musaraj.

E merr fjalën Komisioni i Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sporteve, Komuniteteve Fetare dhe Titujve të Nderit, zoti Ilir Paja.

Ilir Paja : Komisioni ynë vendosi ta kalojë këtë pikë. Pikën 5.

Denisa Luarasi : Faleminderit zoti Paja.

Komisioni Politikave të Zhvillimit Ekonomik, zonja Blerina Reçi.

Blerina Reçi : Komisioni ynë votoi pro. E sjell në Këshill Bashkiak për miratim. Faleminderit

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Reçi.

Komente, pyetje kemi për pikën 5 të rendit të ditës?

Kalojmë në votim.

Kush është pro për pikën 5 të rendit të ditës?

Me 38 vota pro miratohet pa ndryshime dhe pika 5 e rendit të ditës.

- I jepet fjala për projektvendimin e **pikës 6**, Komisionit të Buxhetit, Financave, Taksave-Tarifave zotit Rolant Xhelilaj.

Rolant Xhelilaj : Ok. Komisioni me pjesëmarrjen e numrit të domosdoshëm votoi unanimisht pro votimit të kësaj pike dhe kalimit në mbledhje për miratim.

Denisa Luarasi : Faleminderit zoti Xhelilaj.

Komisioni i Mbrojtjes Civile, Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Shëndetësisë, zonja Xhilola Doçi.

Xhilola Doçi : Pikën 6 komisioni jonë e miratoi që t'i kalojë Këshillit Bashkiak për aprovim.

Denisa Luarasi : Faleminderit zonja Doçi.

Komente, pyetje kemi për pikën 6?

Kalojmë votim.

Kush është pro pikës 6?

Me 38 vota pro miratohet pa ndryshime dhe pika e 6 e rendit të ditës.

- I jepet fjala për projektvendimin e **pikës 7**, Komisionit Rregullores, Çështjeve Juridike zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj : Atëherë edhe për pikën 7, ne e votuam si komision dhe ftojme Këshillin që të jap votën pro. Faleminderit

Denisa Luarasi : Faleminderit zonja Musaraj.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike, zonja Marsida Feshti.

Marsida Feshti : Përshëndetje!

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike është dakort që pika 7 të kalojë për votim në Këshill. Faleminderit.

Denisa Luarasi : Faleminderit zonja Feshti.

Komente, pyetje kemi për pikën 7.

Kalojmë votim.

Kush është pro për pikën 7 të rendit të ditës?

Me 37 vota..., më falni me 38 vota pro miratohet pa ndryshime dhe pika 7 e rendit ditës.

- Kanë kërkuar fjalën **për diskutim** zonja Anisa Ibraj, zoti Ardian Muka, zonja Eda Harizi mungon. Si dhe na kanë ardhur pyetje nga kryesia e grupit qytetar kundër projektit “TID” nga zonja Entela Koja.

Anisa do e merrni fjalën?

Anisa Ibraj : Përshëndetje të gjithëve!

Denisa Luarasi : Më fal Anisa, meqënëse të gjitha pyetjet kanë të bëjnë me projektin “TID” mendojmë që t’i lexojmë të gjithë pyetjet, nëse jeni dakort, dhe pastaj Nënkryetari, Drejtoresha e Ligjorit të na përgjigjen.

Anisa Ibraj : Dakord.

Denisa Luarasi : Okej.

Anisa Ibraj : Përshëndetje.

Atëherë unë do flas për projektin “TID”. Kam takuar banorë që preken nga projekti i TID dhe ne sot nuk diskutojmë kundër zhvillimit të qytetit, përkundrazi. Por zhvillimi duhet të bëhet me respekt për qytetarin dhe pronat e tyre. Projekti “TID” prek drejtpërdrejtë banorët, disa prej të cilëve thonë se nuk janë thirrur në asnjë dëgjese publike dhe nuk janë informuar për këtë projekt. Për më tepër, vlerësimi i pronave rezulton i pabarabartë. Disa marrin një shumë të ulët, patjetër si rezultat i çmimit të referencës. Disa nuk vlerësohen fare. Banorët konkret që janë prekur nga ky projekt, pra si Rita Kazazi, e cila ka dhe biznesin e saj në bulevardin Epidam, Kliton Doka, Kudrete Velja, Isuf Mehmeti. Kërkesat e tyre janë të arsyeshme dhe legjitime. Të ulemi dhe të diskutojmë për projektin, të bëjmë vlerësime të drejta dhe transparente. Ne si Këshill e Bashki duhet të garantojmë dialog dhe zgjidhje të përbashkët. Zhvillimi besoj, biem dakort të gjithë, që duhet të vijë duke, pa cënuar qytetarët.

Atëherë pyetja ime është : A janë bërë dëgjesa publike? Dhe nëse po, kur dhe me kë? Dhe çfarë mbështetje do japim ne si bashki banorëve për t’i strehuar ? Pasi flasim për pensionistë, që gjithë kursimet e tyre i kanë derdhur në ato banesa që kanë, e sidomos për ata që nuk u vlerësohet prona fare. Faleminderit.

Denisa Luarasi : Faleminderit zonja Ibraj.

Zoti Muka.

Ardian Muka : Mirëdita të gjithëve.

Me thënë të drejtën unë isha drejtuar dhe me një kërkesë për informacion me shkrim me numër protokolli 10179, me datë 31.10, ku të njëjtat pyetje pastaj jua parashtrova dhe në kërkesën që kam sot. Gjithmonë pas kontakteve dhe problematikave që qytetarë, ato 74 familje, të cilat janë programuar që nga projekti “TID” i shëmben pronat, meqënëse diskutohet për një problem kaq sensibil që në qytetin tonë natyrisht siç e tha dhe kolegja parafolëse, ne jemi për zhvillimin e qytetit, por nga ana tjetër duhet që secili të dëgjohet të informohet dhe të trajtohet në respekt të pronës, e cila është diçka e shenjtë, të trajtohen në mënyrë të barabartë të gjithë.

Për këtë do t’i bie shkurt, meqënëse ka dhe kolegë të tjerë, të cilët kanë kërkuar fjalën.

Në dokumentacionet që unë kam kërkuar është pika një, procedurat administrative të ndjekura për miratimin e planit të detajuar vendor në lidhje me projektin “TID” Durrës.

Vendimmarrjet përkatëse, pika dy. Vendimmarrjet përkatëse të Këshillit Bashkiak lidhur me këtë plan dhe datat e miratimit të tij, pra me planin e detajuar vendor që ka lidhje me projektin “TID”.

Pika tre, marrëdhënia e këtyre vendimeve me Vendimin e KKT-së nr. 7, datë 2.4.2024 dhe me Vendimin e Këshillit të Ministrave në lidhje me shpronësimet në këtë zonë.

Natyrisht kjo ishte kërkesa e para 10 ditësh, por duke pasur parasysh evolimin e situatës, nuk mund të bëjmë një sy qorr dhe një vesh shurdh, kur ato njerëz janë aty përpara duke protestuar tani përpara bashkisë. Vazhdova me kërkesën e sotme kur kërkoj informacion nga ana e bashkisë në lidhje me ecurinë e projektit në tërësi, pra projekte restaurime, kualifikimi urban i zonës perspektive të “TID” Durrës me vendndodhje në Parkun Arkeologjik Durrës. Përsa i takon kohës së zhvillimit të projektit, pra si jemi me kohën e zhvillimit, ecurisë së procesit të shpronësimeve dhe problematikave të ndryshme që ka hasur ky projekt deri tani. Dhe si pikë të dytë informacion nga ana e këshillit për kohën e aprovimit të planit të detajuar vendor në lidhje me këtë projekt. Në materialet që të paktën unë kam nga 2023 e këndeje neve nuk e kemi kaluar, por duke pasur parasysh që ky projekt ka inicuar që nga viti 2022, kërkojmë që këtë informacion ta kemi nga ana e këshillit, përsa i takon pra projektit të detajuar vendor për këtë zonë.

Ju faleminderit. Pastaj pas përgjigjeve rezervoj të drejtën që të kem të bëj dhe ndonjë replikë me Nënkryetarin.

Denisa Luarasi : Faleminderit zoti Muka.

Nënkryetar, fjala për ju.

Elio Jani : Po përshëndetje të gjithëve.

Faktikisht unë kam pyetjet këtu të këshilltarëve edhe në radhë të parë doja të referoja më shumë për opinionin publik se sa për këshillin që ky nuk është një vendim ose një projekt që po ndodh sot. Ky projekt ka mbi katër vjet që po zhvillohet edhe mua më vjen mirë që ju si këshilltar keni takuar banorët. Unë personalisht edhe kryetari i bashkisë kam mbi katër vjet që i takoj banorët çdo ditë madje, sepse e para jam qytetar i Durrësit dhe e dyta më lidh shumë me këtë zonë dhe banorët nuk është e vërtetë që nuk kanë pasur informacion kanë të gjithë informacion për këtë.

Është tjetër gjë që banorët preken dhe kjo dhe këtu i kuptoj i mirëkuptoj, sepse kanë drejtë, sepse bëhet fjalë për shtëpitë e tyre dhe është e drejtë deri diku dhe pretendimi që ato kanë për pjesën që mund t'i prishësh, shembet banesa e të tjerë. Këtu jam me banorët, por që banorët nuk janë të informuar, nuk kanë informacion, këtu nuk janë banorët, sepse kjo nuk është e vërtetë. Edhe banorët e dinë këtë. Nuk nuk ma thotë njeri dot këtë që nuk i kam takuar banorët.

Në lidhje me pyetjen e zonjës Ibraj, doja t'ju thoja që bashkia e Durrësit ka bërë dy dëgjesa publike, një në vitin 2021 në dhjetor të 2021-it edhe një në shtator të vitit 2022. Në dhjetor 2021 është zhvilluar tek Pallati i Kulturës, ka pasur prezencë të anëtarëve të Këshillit Bashkiak një pjesë janë sot anëtarë këshilli. Unë kam qenë vetë anëtar këshilli dhe kam qenë në 2021-in tek Pallati i Kulturës. Ka pasur dhe banorë që preken nga projekti, banorët që janë sot që protestojnë këtu kanë qenë dhe aty banorët dhe madje disa banorë, kush besoj në qoftë se mund t'i mbajnë mend, kishin dhe pretendimet e tyre asaj kohe dhe i shprehen te ministri i kohës. Pretendimet që ato kishin. Ne kemi dhe foto. Në qoftë se doni mund t'u vëmë në dispozicion foto të takimit.

Anisa Ibraj : Janë bërë dëgjesa ? Kanë qenë prezent apo jo?

Elio Jani : Jo jo patjetër, patjetër. Jo jo. Keni shumë të drejtë.

Jo jo patjetër. Ne kemi dhe fotot. Ne kemi dhe fotot të aktivitetit. Në qoftë se doni japim edhe fotot.

Takimi i dytë është bërë Ok..... Është bërë te Muzeu Arkeologjik në vitin 2022.

Më mbrapa në vitin 2023 ka pasur dhe një prezantim nga kryeministri për projektin. Që do të thotë që ky projekti nuk është diçka që po ndodh sot për nesër. Është një projekt që ka kohë që po zhvillohet.

Ta lidhim me pyetjen e zotit Muka. Projekti që flasim sot, në muajin tetor doja të thoja që është miratuar dhe leja në ndërtimin e bashkisë Durrësit të projektit. Jemi në fazë përfundimtare le të themi. Për pjesën administrative të vendimeve duhet t'jua vë në dispozicion fizikisht, se nuk jap dot tani me numra me datë. Fizikisht jua jap.

Por doja të thoja që plani i detajuar vendor është tagër i kryetarit të bashkisë, nuk është tagër i Këshillit Bashkiak. Prandaj dhe Këshilli ndoshta nuk e ka as si informacion.

Kaq kisha.

Denisa Luarasi : Faleminderit zoti nënkryetar.

Anisa Ibraj : Do pyesja dhe diçka.

Elio Jani : S'do e bëjmë si debat tashi.

Anisa Ibraj : Nuk Ju përgjigje pyetjes së dytë .

Pyetja e dytë është : Çfarë mbështetje do i japim ne këtyre banorëve, përveç çmimit të referencës të caktuar me ligj?

Elio Jani : Faleminderit.

E harrova këtë dhe po, për pjesën e vlerës doja t'jua saktësoja dhe njëherë.

Ligji për shpronësimet flet qartë. Janë dy momente kur një grup pune siç është rasti jonë, në rastin në bashkinë e Durrësit ka mundësi për llogaritjen e vlerës. Janë dy momente, një me çmim reference dhe e dyta me kontratë shitblerjeje të tre muajve të fundit nga ASHK-ja.

Ne për hir të vërtetës kemi zgjedhur kontratën e tre muajve të fundit të referuar nga ASHK-ja, sepse kanë vlerën më të lartë dhe vlera ka qenë 78.000 lekë të reja. Kjo është vlera nga ASHK-ja. Bashkia funksionon me dokument zyrtar me ligjin e shtetit shqiptar. Ligji i shtetit shqiptar parashikon që ASHK-ja është organi i vetëm zyrtar. Ne nuk morëm referencat për kohën, sepse referenca ishin shumë të ulëta dhe menduam për mirë këtë gjë, menduam të vlerësonim dhe pjesën e kontratave të tre muajve të fundit.

Anisa Ibraj : Po ata që nuk mund të vlerësohen?

Elio Jani : Ato që nuk mund të vlerësohen janë dy momente.

Një person mund të ketë dhe atë procesin gjyqësor ku mund ta hedhin në gjyq vendimin dhe në qoftë se gjykata e miraton është një moment tjetër.

Ka dhe pjesën tjetër. Bashkia ka pastaj programe sociale si çdo qytetar tjetër, që mund të merren me këtë pjesë, siç janë bonus qeraje, banesë sociale me qera. Këto janë programet ose kredi e butë janë tre programet që kemi.

Anisa Ibraj : Po, por banorët nuk e kanë këtë si informacion. Thonë që : “Na kanë lënë mes katër rrugëve dhe nuk na kanë ofruar asgjë”.

Elio Jani : Po nuk është ofruar asgjë, se kjo nuk është një marrëdhënie.

Ne po flasim këtu për një proces shpronësimi. Procesi i shpronësimit është, rregullohet me ligj të posaçëm. Kjo nuk është marrëdhënie shkëmbimi. Ne nuk i themi dot banorëve lëre shtëpinë tjetër të japim këtë. Banorët duhet të aplikojnë të gjithë banorët e tjerë për një nga këto programe

Anisa Ibraj : Leje shtëpinë që të ndërtoj unë

Elio Jani : Jo nuk po i them lëreni shtëpinë.....

Anisa Ibraj :.....që të zhvillojmë qytetin, këtë po thua ti.

Elio Jani :po zhvillimi i qytetit është....

Denisa Luarasi : Të lutem.

Anisa Ibraj : Banorët nuk e kanë marrë si informacion që duhet mbështeten me këto shërbimet sociale po them

Elio Jani : Nuk na kanë pyetur banorët. Meqenëse me pyete bashkia ka tre programe strehimi, një banese sociale me qera, qeraja 50 % nga bashkia dhe e treta kredia butë. Këto janë 3 programe që kemi për strehimin.

Denisa Luarasi : Faleminderit nënkryetar.

Po z.Muka.

Ardian Muka : Për replikë me atë çfarë tha nënkryetari do doja ta informoja Këshillin, qytetarët por dhe Nënkryetarin, sipas Aktmarrëveshjes ndërmjet Fondacionit Shqiptar Amerikan për Zhvillim (AADF) dhe Bashkisë Durrës, Ministrisë së Kulturës me datë 26.10.2023 është përcaktuar që zbatimi i projektit të rikualifikimit urban për zonën arkeologjike “TID” Durrës duke u mbështetur mbi vendimet paraprake të KKT-së. KKT-ja nga ana e saj është mbështetur në një Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit me nr. 2, me datë 9.12.2022, me miratimin e lejes për zhvillimin për objektin, restaurim, rikualifikimi urban i zonës perspektive “TID” të Durrësit që gjendet në Parkun Arkeologjik në Durrës.

Më pas është dhënë dhe leja e zhvillimit përfundimtar nga KKT-ja me datë 2.4.2024, çka e bën të domosdoshme verifikimin, ndërsa Këshilli Bashkiak i Durrësit a ka qenë në dijeni dhe ja ka dhënë miratimin paraprak të detyrueshëm ligjërisht përpara këtyre vendimeve.

Atëherë kjo kërkesë dhe këto çfarë unë thashë mbështeten në Ligjin numër 107 të vitit 2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” në nenet 22, 47 dhe 48. Në VKM nr.408, datë 13.5.2015 “Për rregullat dhe procedurat e miratimeve të planeve vendore të zhvillimit”. Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, që përcakton rolin e Këshillit për miratimin e planeve dhe

projekteve që prekin territorin dhe Ligji nr.119 i 2014-s, “Për të drejtën e informimit” natyrisht që garanton akses publik në dokumentet dhe vendimet zyrtare të institucioneve publike. Pra, këshilli e ka për detyrë që PDV-në, planin e detajuar vendor duhet të kalonte patjetër me një aprovim nga ana e Këshillit Bashkiak të qytetit Durrës.

Denisa Luarasi : Është kompetencë e kryetares së bashkisë.
E ke gabim? Bazuar në ligjin.....

Ardian Muka : Në këto ligje, në këto akte ligjore që unë lexova, është e përcaktuar.....

Elio Jani : O zoti Muka.
Ky është pretendimi jonë.
Tani ne nuk kemi ardhur për të bërë debat me ty për diçka.

Ardian Muka : Unë thjesht po lexoj për informim.

Elio Jani: Po çka informimi, informimi nuk është.. salla e Këshillit Bashkiak nuk është informacion. Këtu jemi të gjithë këshilltar, jemi koleg, nuk ka lidhje informimi këtu.
Ju bëtë një pyetje.

Ardian Muka : Nuk janë të gjithë specialistë dhe nuk duhet të dizinformohen, them unë.

Elio Jani: Unë s' kuptoj. Ju pyesni apo jo? A pyesni?
Morët përgjigjen time. Tani kjo është përgjigjja ime, nuk do bëj debat.

Ardian Muka : Pra përgjigjja juaj është që nuk ka nevojë të kalojë nëpërmjet Këshillit Bashkiak PDV-ja? Kjo ishte.
Po, faleminderit.

Denisa Luarasi : Plani i detajuar vendor nuk është kompetencë e Këshillit sipas nenit 12 dhe 22 të Ligjit nr.107/2014. Megjithatë ne ftojmë drejtoreshën ligjore të na sqarojë për pyetjet që kanë drejtuar qytetarët.
Pyetja e zonjës Entela Koja.

Alneida Rroshi (Drejtoresh pranë Drejtorisë Ligjore) : Të nderuar këshilltarë, përshëndetje.
Unë dua të ndalem në të gjitha pikat, të cilat kanë bërë qytetarët me përfaqësuesit e tyre.
Përsa i përket lidhur me procedurën e ndjekur nga Bashkia Durrës për projektin e restaurimit, rikualifikimit në zonën urbane të ardhshme “TID” Durrës, ju informojmë si më poshtë.
Zona e ardhshme “TID” Durrës ndodhet brenda zonës arkeologjike A, e cila fillon nga Kulla Veneciane në jug e në perëndim përgjatë mureve të periudhës romake afërsisht 490 m deri në Kullën e Gardës në veri. Në lindje shtrihet në kufij në rrugën Imzot Fan Noli e deri në rrugën Egnatia në jug duke përfshirë ndërtesat në anën veriore përgjatë rrugës Egnatia dhe deri në kryqëzimin e Velierës. Qëllimi kryesor i projektit TID është “Projektimi, restaurimet dhe rikualifikimet urban të zonës së ardhshme TID, e cila ndodhet brenda zonës arkeologjike A të

qytetit të Durrësit”, siç tregohet edhe në hartën tashmë të miratuar në mënyrë që të rritet turizmi dhe si pasojë zhvillimi ekonomik i zonës përmet restaurimit, rehabilitimit të shtëpiave tradicionale, shesheve dhe rrugëve brenda zonës të treguara kufitare. Zona e projektit TID ndodhet në pjesë në pjesën jugore në afërsi të Portit.

Bashkia e Durrës ka nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi midis Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Albanian American Development Foundation, në të cilën ministria është institucioni përgjegjës për mbrojtjen, ruajtjen, administrimin e pasurisë kulturore. Gjithashtu ju bëj me dije se në zbatim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të sipërcituara protokolluar me shkresën tonë 7773/1, datë 2.10.2023, AADF angazhohet që të financojë deri në vlerën pothuajse 6 milion \$ për ndërhyrjet në infrastrukturë në zonën TID si dhe modelin e administrimit/menaxhimit të zonës TID. Theksojmë që zona në të cilat do të menaxhohet ky projekt është një pjesë e rëndësishme e pasurisë kombëtare dhe arkeologjike jo vetëm të një individi, por të gjithë qytetit dhe mbarë vendit. Projekti synon të rijetizojë zonën e projektit, kufijte gjeografikë, ku ndodhet kufiri TID, bashkëlidhur si një pjesë përbërje e kësaj marrëveshje si dhe të krijojë një model zone të zhvillimit të biznesit të turizme sipas modelit BID, i cili në periudhën afatgjatë do të ndihmojë në përmirësimin e ofertës turistike, shërbimeve të promovimit të zonës së projektit, duke sjellë kështu një zhvillim ekonomik për zonën e projektit dhe qytetit të Durrësit në tërësi.

Projekti parashikon objektet e mbetura gjatë periudhës otomane do të ruhen siç janë në momentin e ndërtimit 9 objekte. Dominon arkitektura italiane e viteve 30, e cila vërehet në të dyja anët e bulevardit. Vërehet ndryshimi i gjurmës së rrugës tregtare në vitet 20 dhe të bulevardit të viteve 30 sot. Elementet dhe ngjyrat e dekoreve të fasadës paratapetet do të ruhen dhe do rikthehen në origjinalitet. Zëvendësimi i dymëve të dritareve me dru duke hijëzuar tiparet e tipologjisë “persiane”. Krijimi i shesheve të reja, çlirimi i Amfiteatrit, rikthimi i bulevardit në identitet si dhe pedonalja që ka një sipërfaqe prej 1600 m². Ndërhyrje në infrastrukturë, plani i mobilitetit, arredimi urban, muret e kalasë, shtrimi i bulevardit, etjere....

Besoj që të gjitha këto informacione janë edhe në miratimin e projektit të till dhe sipas Vendimit nr.7 . Ajo çfarë unë dua t'i kthehem përgjigjes përsa i përket nga ana juaj të gjithë kërkesës që ka ardhur nga një përfaqësues i banorëve, Këshilli Bashkiak ka vendimmarrje nëse ka dhënë miratim paraprak lidhur me këtë projekt.

Sqarojmë se bazuar në nenin 54 të Ligjit 139 të 2015-s “Për vetëqeverisjen vendore”, detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak nuk shtrihen në miratimin e projekteve, të cilat nuk mbulohen me fondet buxhetit të bashkisë. Ju përsërisim se ky projekt ndiqet dhe financohet nga AADF-ja, e cila është një organizatë jo fitimprurëse e krijuar në vitin 2009 nga Fondi Shqiptaro Amerikan për ndërmarrjet e cila ka një mision të ndihmojë për zhvillimin e një ekonomie të qëndrueshme të sektorit privat dhe të një shoqërie demokratike në Shqipëri dhe të kontribuojë në stabilitetin e Europës Juglindore. Ndërmjet programeve të saj të sipërmarrjes, turizmit kulturor, ekoturizmit dhe një edukim dhe lidhshirë. Në zbatim të memorandumit të mirëkuptimit lidhur me datën 9.6.2020 AADF ka angazhuar fonde me shumën prej 260.000\$ pa TVSH për përgatitjen e projektit të detajuar për ndërhyrjet në infrastrukturë për zonën e projektit të ashtuquajtur “TID Durrës” ose “Zona e Projektit” (“Projekti i ndërhyrjes në infrastrukturë”), i cili është miratuar nga autoritetet publike konkretisht me Vendimin numër 461, datë 16.9.2022 të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore dhe Materiale.

Për sa i përket pyetjes numër 2, të cituar përsëri nga qytetarët lidhur me argumentin mbi kontrollin....

....Ndërhyn qytetarja...

Alneida Rroshi: Po ju jap përgjigje...

Entela Koja (përfaqësuese e qytetarëve të projektit TID): I kërkohet Këshillit Bashkiak a ka informacion për projektin e detajuar?

Alneida Rroshi: Ju jap përgjigje, për sa i përket....

Po edhe për këtë, edhe për këtë do të përgjigjem, i kam

Lidhur me argumentin tuaj mbi kontrollin e mirëmbajtjes dhe ligjshmërisë së projekteve ju informojmë se konstatimet tuaja dhe baza ligjore përmendet si më poshtë:

Bazuar në nenin 8, të Ligjit nr.8561, të 99-s “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik” i ndryshuar, thuhet se :

“.... Në funksion të interesit publik, shpronësimi mund të bëhet për këto shkaqe... Për realizimin e projekteve dhe investimeve kombëtare dhe vendore, në funksion të ruajtjes së mjedisit, të shëndetit, kulturës dhe arsimit publik, si dhe të infrastrukturës, në shërbim të interesit publik.”

Nga sa më lart konstatohet se procedura e ndjekur nga ana e administratës së Bashkisë Durrës lidhur me vlerësimin paraprak të pasurive bazohet në legjislacionin në fuqi, por patjetër dhe në projektet e zonës arkeologjike “TID” për zhvillimin e ruajtjes së trashëgimisë kulturore.

Ky projekt i konsultuar dhe i miratuar nga institucionet përgjegjëse me Vendimin nr. 461.....,

Ndërhyn qytetarja...

Alneida Rroshi: Të lutem ta mbaroj sepse është e pamundur që unë.....

Denisa Luarasi : Të lutem jo debat në sallë zonja Koja.

Të lutem të respektojmë drejtoreshën.

Alneida Rroshi : Projekti i konsultuar dhe i miratuar nga institucionet përgjegjëse me Vendimin nr.461 të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore dhe Material si dhe me Vendimin e AZHT-së nr 7, datë 2.4.2024, “Miratimin e lejes së zhvillimit për objektin: Restaurimi dhe rikualifikimi i zonës “TID” të gjendur në Parkun Arkeologjik Durrës dhe me zhvillues Bashkia Durrës”. Vendimmarrja e Këshillit Bashkiak, i cili me Vendimin nr. 32, datë 23.6.2025 “Për miratimin e disa ndryshimeve në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 110 të 2024-s të vlerës së shpronësimit për pronat private që preken apo zhvlerësohen nga realizimi i projektit TID, për zhvillimin dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore”, bazohet në legjislacionin në fuqi dhe në çdo akt tjetër administrativ, marrëveshje apo bazë ligjore, që Bashkia e Durrës si përfituese e këtij projekti ka sqaruar në relacionet përkatëse në vitin 2024-2025.

Baza ligjore e përmendur në argumentin e banorëve, konkretisht neni 32 i ligjit 139, ka të bëjë me administrimin e shërbimeve publike nga ana njësisë që qeverisjes vendore, ndërsa neni 45 i Ligjit 107 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar ka të bëjë me kushtet e infrastrukturës kryesore dytësore, ndërsa neni 45/1 ka të bëjë me kushtet e përshtatshmërisë së

mjedisit, standartet e përshtatshmërisë për personat me aftësi të kufizuara apo dispozitave të përcaktuara në rregulloren apo shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara, etjerë.... Sidoqoftë, edhe pse baza ligjore e kërkuar në shkresën zyrtare në argumentin tuaj nuk qëndron, jemi të mendimit se kemi qenë shumë të qartë në argumentin tonë për procedurën e ndjekur nga Këshilli Bashkiak.

Lidhur me argumentin tuaj për përgjegjësinë institucionale.

Së pari sqarojmë se projekti i tij përfshin dy komponentë kryesorë, financimin e zbatimit të një pjese të projektit të ndërhyrjes në infrastrukturë dhe krijimin e “TID” Durrësi sipas modelit të zonave të përmirësimit të biznesit (BID), në përputhje me Ligjin 63/2020-s “Për përmirësimin e zonave të biznesit”. Zbatimi i projektit kushtëzohet nga procesi i shpronësimit dhe i prishjeve që do të kryhet nga qeveria shqiptare.

Së dyti, Bashkia e Durrës në zbatim të Memorandumit të 2020-s, ka një angazhim të përbashkët me palët në këtë marrëveshje si AADF-ja dhe Ministria e Kulturës, që në një mënyrë solidare palët në këtë marrëveshje i qëndrojnë parimeve kryesore të kësaj marrëveshje.

Ndër të tjera janë:

- përmirësimi dhe ruajtja e trashëgimisë;
- krijimi i një modeli inovativ të menaxhimit të zonës;
- administrimi më i mirë i zonës së projektit, ku bizneset lokale janë pjesëmarrës dhe nxitës kryesorë të saj;
- përmirësimi i reputacionit të Durrësit si destinacion turistik, duke shfrytëzuar potencialin e turizmit kulturor dhe historik;
- ruajtja e trashëgimisë kulturore, zhvillimi i biznesit dhe turizmit në qytetin e Durrësit.

Përsa i përket bashkërendimit institucional dhe konsultimit publik, më poshtë ju sqarojmë në mënyrë të detajuar procesin e zhvillimit në dëgjesat publike.

- Dëgjesa e parë publik është zhvilluar me datën 7.12.2021 në Qendrën Kulturore “Aleksandër Moisiu” me pjesëmarrjen e kryetares së bashkisë, Ministrisë së Kulturës dhe Inovacionit, përfaqësues të AADF-së, anëtarë të këshillit bashkiak, qytetarë dhe përfaqësues të bizneseve të zonës.
- Në datën 14.9.2022 pranë Muzeut Arkeologjik me pjesëmarrjen e kryetares së bashkisë, Ministrisë së Kulturës dhe Inovacionit, grupit të interesit ku hodhën ide mbi menaxhimin e trashëgimisë kulturore.
- Gjithashtu me datën 12.5, pranë Amfiteatrit me pjesëmarrjen e kryeministrit, kryetares së bashkisë, Ministrisë së Kulturës dhe Inovacionit është bërë prezantimi i projektit “TID”.

Unë mund të ndalem edhe më shumë dëgjesat publike se çfarë është thënë në ato dëgjesa publike apo për t'ju vendosur edhe informacion më tepër.

Të lutem lidhur me argumentin mbi ndalimin e punimeve.....

Entela Koja (përfaqësuese e qytetarëve):Flet pa mikrofon....

...Juve bëni shkarje nga një ligj, i cili është në plan menaxhim. Në plan menaxhimi hapeni dhe shikojeni ku e ka, ligji është 169/20.2.....

Elio Jani : Drejtoreshë faleminderit.

Kjo është përgjigjja jonë.

Të lutem tani, nuk kemi debat.

Denisa Luarasi : Faleminderit zonja Rroshi.

Edlira Shemsi : Kam të drejtë se kam bërë....

Denisa Luarasi : Zonja Harrizi, pyetjet e tua u ezauruan, sepse ishit me vonesë edhe u ezauruan. Faleminderit. Ju falenderoj për prezencën. Mbledhjen e deklaroj të mbyllur. Takohemi në mbledhjen e radhës. Faleminderit.

Edlira Shemsi:flet pa mikrofon... u tha, u tha....

Denisa Luarasi: Ju lutem ishit me vonesë dhe u ezauruan pyetjet, të lutem znj.Harrizi.

Edlira Shemsi :vazhdon flet pa mikrofon..... nuk u tha si u bë ndryshimi i këtij projekti.....
...ndërkohë që mbledhja është mbyllur.

Ky procesverbal mbyllet me nr. rendor 14 (katërmëdhjetë) faqe, i cili pasi verifikohet firmoset nga drejtuesi i seancës, sekretari i këshillit dhe 3(tre) këshilltarë.

Mbajtësi i procesverbalit: Nikol Muka

Komisioni i Verifikimit të Procesverbalit :

Drejtues i seancës (Zv/kryetar i Këshillit Bashkiak) : DENISA LUARASI

Sekretar i Këshillit Bashkiak : DORINA MILJA

Këshilltar (Zv/kryetar i Këshillit Bashkiak) : EDLIRA DEVOLLI

Këshilltar (Kr. Grupi) : ROLANT XHELILAJ

Këshilltar (Kr. Grupi) : RENALD KOKA